



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:291280
Datë: 08.10.2024
Numri i dokumentit: 06269850

K.Dh.Sh.II.nr.1000/24

GJYKATA KOMERCIAL E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtaren individuale Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbartimore të kreditorit N.P.N “Ballkan Project” me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Zaim Istrefi nga Prishtina, kundër debitorit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS) Sh.A me seli në Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2224/23 të datës 01.03.2024, me datën 08.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS) Sh.A me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2224/23 të datës 01.03.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2224/23 të datës 01.03.2024, në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS) SH.A, ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr. 319/2023 i datës 30.11.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Eset Murati dhe i njejtë Urdhër ka mbet në fuqi në tërësi. Ndërsa në pikën II të dispozitivit ka detyruar debitorin që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim, t'ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej EUR 312.00 (treqind e dymbëdhjetë euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljes së dispozitivave të procedurës përmbartimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anulohet aktvendimi i ankimuar dhe çështja të kthehet të rivendosje.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit N.P.N “Ballkan Project”, përmes urdhrit përmbartimor P.nr. 319/2023 të datës 30.11.2023, ka caktuar zbatimin e përmbartimit në bazë të titullit ekzekutiv Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike V.EK.nr. 77/2021 i datës 27.10.2021, i vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë K.Dh.Sh.II.nr. 830/22 të datës 20.09.2023, me të cilin ka detyruar debitorin, t'ia paguaj borxhin në shumën prej 33,068.27 EUR, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 30.12.2015 e deri në pagesën

definitive dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 2,750.00 EURO, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga marrja e aktvendimit nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Debitori në prapësimin e paraqitur ka shtuar se e kundërshton në tërësi urdhrin për lejimin e përmbarrimit, me arsyetimin se dokumenti në bazë të cilit është paraqitur propozimi për përmbarrim, përkatësisht është lëshuar Urdhri për Përmbarrim, nuk përmban tipare të përmbarrueshmërisë në kuptim të nenit 71 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore dhe se urdhri është lëshuar me aplikim të gabuar të së drejtës materiale, e njëkohësisht ka shkelur dispozitat procedurale në vërtetim të gabuar të gjendjes faktike. Po ashtu ka theksuar se me datë 08.12.2023 debitori ka ushtruar revizion kundër Aktgjykimit të Shkallës së Parë dhe Aktgjykimit të Shkallës së Dytë dhe se në mungesë të të njëjtit është e parakohshme. Andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit Kompania Kosovare për Distribuim me Energji Elektrike Sh.A, të anulohet Urdhri për Përmbarrim P.nr. 319/23 i datës 30.11.2023, si dhe të obligohet kreditori që t'i bartë shpenzimet përmbarrimore në tërësi.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim duke theksuar se pretendimet e debitorit janë në tërësi të pa bazuara, kjo për faktin se dokumenti në bazë të cilit është ushtruar propozimi për përmbarrim është dokument përmbarrues dhe se i njëjti i përmban të gjitha tiparet e përmbarrueshmërisë ashtu siç është përcaktuar me nenin 22 dhe 27 të LPP-së, e po ashtu vendimi i gjykatës së shkallës së parë në bazë të cilit është ushtruar propozimi për përmbarrim është i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm. Pastaj kreditori ka shtuar se sa i përket pretendimit se debitori ka ushtruar Revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës dhe ndjekja e procedurës përmbarrimore është e parakohshme, është i pa bazë dhe i pa qëndrueshëm dhe se të njëjtat janë ushtruar vetëm sa për të zvarritur procedurën për ekzekutim të vendimit.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2224/23 të datës 01.03.2024, në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS) SH.A, ndërsa Urdhri Përmbarrimor P.nr. 319/2023 i datës 30.11.2023, i lejuar nga Përmbarruesi Eset Murati dhe i njëjti Urdhër ka mbet në fuqi në tërësi. Ndërsa në pikën II të dispozitivit ka detyruar debitorin që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim, t'ia paguaj kreditorit shumën e

përgjithshme prej EUR 312.00 (treqind e dymbëdhjetë euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se dokumenti përmbartimor, përkatësisht Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike V.EK.nr. 77/2021 i datës 27.10.2021, i plotëson kushtet e përcaktuara edhe me nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmërisë për përmbartueshmëri”* ngase i njëjti është pajisur me klauzolë të përmbartueshmërisë sipas të cilës rezulton se aktgjykimi është bërë i plotfuqishëm me datë 20.09.2023 dhe i ekzekutueshëm nga data 24.11.2023.

Gjykata Komerciale- Dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj konkludimi e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit lidhur me atë se aktvendimi i ankimuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës përmbartimore, për faktin se në rastin konkret dokumenti përmbartues në bazë të cilit është lejuar përmbartimi është Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike V.EK.nr. 77/2021 i datës 27.10.2021, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 20.09.2023 dhe i ekzekutueshëm nga data 24.11.2023 i cili në rastin konkret është dokument përmbartues, e kjo parashihet në nenin 22 paragrafi 1 pika 1.1 të LPP-së, e cila përcakton se: *“dokument përmbartimor është vendimi përmbartues i gjykatës dhe ujdia gjyqësore përmbartuese”* dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbartimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 dhe 27 paragrafi 1, i po këtij ligji ku përcaktohet se: *“dokumenti përmbartimor është*

i përshtatshëm për përmbarrim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit”, andaj pretendimet ankimore të debitorit se gjykata ka bërë shkelje dhe interpretim të gabuar të dispozitave të LPP-së, me rastin e refuzimit të prapësimit nuk qëndrojnë.

Gjykata mori parasysh pretendimet ankimore të debitorit, mirëpo të njëjtat i gjeti si të pabazuara ngase aktgjykimi është bërë i formës së prerë dhe të ekzekutueshëm, andaj i plotëson kushtet për caktimin e përmbarrimit në pajtim me dispozitat ligjore të LPP-së.

Nuk janë pranuar as pretendimet për gjendjen faktike sepse gjykata përmbarrimore me saktësi ka konstatuar rrethanat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarrimi përfshirë edhe kushtet formale nga të cilat varet lejueshmëria e përmbarrimit.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhomat e shkallës së dytë

K.Dh.Shk.II.nr1000/24, me datën 10.08.2024

Gj y q t a r j a,
Franciska Zhitija Ymeri